

Dr. Nikollë Loka

POLITIKA ARSIMORE ITALIANE NDAJ SHQIPËRISË DERI NË VITIN 1912

Kultura e Perëndimit është elementi më i hershëm i kulturës dhe shkrimit të lartë shqiptar. Ajo erdhi në territorin verior shqiptar së bashku me misionet katolike. Tekstet e parane shqip janë vepra fetare të shkruara nga priftërinjtë katolikë. Në territorin e gegëve shkrimi shqip u zhvillua falë urdhrave të françeskanëve, jezuitëve dhe më pas edhe të dominikanëve, të cilët drejtonin shkollat katolike ku mësonin priftërinjtë e ardhshëm. Edhe misionarët italianë, që erdhën në trevat shqiptare, e patën detyrim të mësonin të lexonin dhe të shkruanin shqip. Nga ana tjetër, më të mirët nga studentët shqiptarë vazhduan arsimin e lartë katolik në Perëndim dhe kryesisht në Itali (Sawicka, 215: 95).

Tradita e shkollave shqipe të subvencionuara nga italianët është e herëshme. Shkolla të rëndësishme u krijuan që nga fundi i shek. XVI në Venedik te vëllazëritë, si dhe në kolegjet fetare për shqiptarët, që i gjejmë në disa qytete të rëndësishme të bregdetit të Adriatikut e në territoret e Mbretërisë së Napolit, ku u mirëpritën një pjesë e konsiderueshme e refugjatëve dhe emigrantëve nga trevat shqipfolëse të Ballkanit. Këto komunitete gjetën në Itali forcën kulturore dhe shpirtërore që u lejonte, jo vetëm të mos asimiloheshin nga mjedisi përreth, por edhe të rigjeneronin identitetin e tyre (Altimari, Gli Arbëreshë d'Italia, Academia.edu). Një interes të madh ndaj komunitetit shqiptar në Ballkan dhe

të atij arbëresh në Itali filloi ta sillte veprimtaria e zhvilluar nga papa Klementi XI, nga familja Albani, me origjinë shqiptare (1700-1721), por një kthesë të vërtetë në historinë fetare, politike, kulturore e qytetare të komunitetit arbëresh në Itali shënoi fillimisht themelimi i dy kolegjeve arbëreshe në Kalabri dhe në Siçili me interesimin e papa Klementit XII (1730-1740). Këto qendra të rëndësishme arsimore ishin Kolegji Korsini (1732) në Shën Benedhit në Kalabri, mbështetur fuqishëm nga vëllezërit Stefano e Felice Samuele Rodotà, dhe Seminari Arbëresh i Palermos në Siçili, i themeluar në vitin 1734, me nismën e At Gjergj Guxetës (Altimari, 2016, Academia.edu).

Me krijimin e Italisë së bashkuar dhe sidomos pas Kongresit të Berlinit (qershor-korrik 1877), kur Mbretëria e Italisë filloi të përvijonte një projekt koherent të politikës së jashtme, trevat shqiptare hynë në sferën e interesit italian. Në fund të fundit, i gjithë gadishulli Ballkanik ishte kthyer në një skenar gjeostrategjik me rëndësi parësore për Italinë (Basciani, 2013: 503), e cila investoi shuma gjithnjë e më të mëdha për të mbrojtur interesat e saj në Shqipëri (Altimari, Arbëreshë d'Italia :2012: 6-7). Në përpjekjet për zgjerimin e ndikimit Italian në Ballkan, rreth vitit 1900, Shqipëria u bë një çështje gjithnjë e më e rëndësishme në jetën publike italiane (Altimari, Arbëreshë d'Italia:2012: 14).

Rilindja kombëtare shqiptare përmes arbëreshëve dhe hapja e shkollave shqipe

Përpara dy kolegjeve arbëreshe, të themeluara në shekullin e tetëmbëdhjetë në Kalabri dhe Siçili për trajnimin e klerit të komunitetit katolik shqiptar të rritit bizantino-grek. Kolegji Grek i Romës dhe Manastiri i Mezzoiuso që shërbyen për të ushqyer këtë lidhje me identitetin e përbashkët greko-bizantin të territoreve ballkanike të origjinës (Altimari, Arbëreshë d'Italia:2012: 2). Kolegji Grek i Shën Athanasit është më i hershmi ndër kolegjet ortodokse lindore të Romës, i themeluar nga Papa Gregori XIII, me Demin e 13 janarit 1576, në *Apostolicae Sedis specula*. Kolegji ishte i hapur dhe pranonte studentë ortodoksë, grekë, italo-shqiptarë dhe shqiptarë. Përveç klerikëve katolikë shqiptarë të rritit lindor, në këtë kolegji jezuitët përgatitën edhe klerikët ortodoksë shqiptarë, pasi Shqipërisë në atë kohë i mungonin shkolla të vetat për përgatitjen e klerikëve ortodoksë. Një kontribut të rëndësishëm në edukimin e klerit shqiptar dha edhe Kolegji Ilirik i Loretos në Itali, i themeluar nga Papa Gregori XIII në vitin 1580 dhe i vënë nën drejtimin jezuit (Murzaku, 2017: 84-85).

Ndër institucionet arsimore të kishës arbëreshe lindore, ku përfshihen sidomos qendrat formuese të klerikëve të komunitetit arbëresh të Italisë së jugut, ishte Manastiri bazilian i Munxifit (Mezjojusos), i themeluar në vitin 1609 nga Andrea Reres në Siçili. Ky kolegji ka qenë e para qendër arsimore kishtare e Arbërisë siçiliane dhe më e rëndësishmja, deri në gjysmën e parë të shek. XVIII. Aty studionin dhe vepronin "grekë" të ndryshëm: shumica arbëreshë vendas, grekë "venedikas" të gadishullit të Moresë (Peloponezi i sotëm) dhe të ishullit Kandja (Kreta e sotme), si dhe ndonjë italian i kishës "italo-greke", që mbijetonte ende në Italinë e jugut në atë

periudhë, si pasojë e sundimit të gjatë bizantin në ato treva. Në këtë manastir studiohej greqishtja liturgjike, por i gjallë ishte edhe interesi ndaj arbërishtes, që u shërbente murgjëve në misionet e tyre fetare në Shqipërinë e jugut, sidomos në Himarë, ku u duhej doemos të përdornin shqipen, krahas greqishtes (Altimari, *Napoli*, 2016: 4).

Nevoja për t'u dalluar nga grekët i shtyu klerikët intelektualë arbëreshë të vinin në pah veçoritë gjuhësore, fetare dhe kulturore të etnisë së tyre, duke i hapur rrugë çështjes kombëtare që do të lindte në dhjetëvjeçarët më vonë. Në fakt, këto dy shkolla, krahas ndihmës për ruajtjen e ritit bizantin në Itali, u bënë dhe qendrat kryesore të formimit kulturor për intelektualët arbëreshë, deri në fund të shek. XIX (Vaccaro, 2008: 147; Tare:2021: 80; (Altimari, *Arbëreshë d'Italia*: 2012 : 3).

Kanë qenë misionarët arbëreshë që vinin nga manastiri bazilian i Munxifsi ata që hapën shkollat e para shqipe në Jugun e Shqipërisë. Qëllimi i këtyre shkollave në Himarë ishte kryesisht fetar, mbrojtja e besimit të krishterë sipas ritit bizantin, por brenda kishës katolike, që kërcënohej qoftë nga sundimi osman, qoftë edhe nga Kisha ortodokse greke. Ndër murgjit bazilianë arbëreshë por edhe italianë, katolikë të ritit bizantin, që morën pjesë nga gjysma e shek. XVII deri në gjysmën e shek. XVIII në këto misione të përkrahura nga Kongregata “De Propaganda Fide” mund të përmendim misionarët: Nilo Catalano, italian me origjinë nga Messina, që më pas u arbëreshizua nga ana kulturore dhe gjuhësore; Filoteo Zassi e Callinico Granà nga Munxifsi; Basilio Matranga e Giuseppe Schirò, të dy nga Hora e Arbëreshëve (Altimari, *Napoli*, 2016: 5).

Ndërkohë që Selia e Shenjtë ua bëri me detyrim misionarëve që do të dërgoheshin në Shqipëri ta mësonin gjuhën shqipe, u shtua interesi për të përgatitur klerikë vendës me arsim të lartë teologjik, të cilët do të shërbenin edhe si mësues, duke hapur shkolla shqipe në vend. Për ta realizuar këtë synim dhe për t'u ardhur në ndihmë bashkatdhetarëve të tij, Papa Klementi XI themeloi një vend të përhershëm në Kolegjin e Propagandës për shqiptarët (Shllaku, 2002: 163). Në vitin 1713, në shkollën “San Pietro” në Montorio të Romës, me angazhimin e drejtpërdrejtë të tij filloi punë katedra e gjuhës shqipe. Mësimdhënës të kësaj katedre ishin italo-shqiptarët (Shllaku, 2002 : 55).Për mësimin e shqipes në shkollat italiane ishte përgatitur gramatika e parë sistematike e shqipes, në shek. XVII nga Francesco Da Lecce (Sawicka, 2015: 98). Në vitin 1736, për herë të parë filloi të shkruhej gjuha shqipe dhe, kësaj për arbëreshet filloi një epokë e re e arsimit kombëtar dhe një epokë e re e gjuhës shqipe (Tare:2021: 80). Kur në krye te Kolegjit do të vendosej Imzot Zef Skiroi, nën drejtimin e tij dhe falë insistimit të Jeronim de Radës, u arrit te themelohej katedra e gjuhës shqipe. Krijimi i katedrës së gjuhës shqipe, në Kolegjin arberesh të Shen Adrianit, ndihmoi për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe me shkrim nëpër ngulimet arbëreshe të Italisë. Shqipja deri atëherë përdorej nga nxënësit vetëm në kumtimet me gojë me njëri-tjetrin (Tare: 2021: 83). De Rada, u bë mësuesi i parë i shkollës shqipe. Dëshira e tij për hapjen e shkollës në gjuhën shqipe, vihet re dhe në letërkëmbimet e kohës (Tare:2021:83) me atdhetarëve të ndryshëm, ndër të cilët dhe me Dora d’Istria, ku vë në dukje përpjekjet e

arbëreshëve të Kalabrisë dhe Siçilisë për rimëkëmbjen e Shqipërisë.

Lëvizjet kulturore arsimore, Dora D'Istria i shikonte si pjesë përbërëse e lëvizjes kombëtare shqiptare, e cila për vetë kushtet dhe rrethanat fillimet do të niste në kolonitë arbëreshe të Italisë. Ajo përmes letrave dëshmonte vlerën e atdhetarëve arbëreshë në rilindjen e popullit shqiptar dhe bënte çmos për kthimin e atyre kolegjeve në vatra arsimore kombëtare shqiptare. Në një nga letrat e saj shkruante: “Shqiptarët e Italisë së Jugut, nga vetë pozita e tyre, nga patriotizmi i tyre i patundur, janë pikërisht ata që do të bëjnë të rilindë një popull që ka pasur fatkeqësira në shekuj me radhë” (Tare:2021:79). Nga fillimi i vitit 1867, intelektualë arbëreshë si Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Vincens Dorsa, etj., morën iniciativën të parashtronin në Parlamentin italian një kërkesë për futjen e gjuhës shqipe në programin e shkollave dhe institucioneve arsimore, si dhe për gjallërimin e jetës në kolegjet arbereshe.

Nuk duhet harruar se Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e njohur dhe e marrë në konsideratë nga e gjithë Evropa, ishte rritur dhe mbajtur gjallë nga kolonitë në Itali, me anë të studimeve gjuhësore dhe letrare; se te të rinjtë shqiptarë përtej Adriatikutkishin ndjerë nevojën urgjente për një lëvizje të tillë kombëtare më shumë se kurrë. (Tare,2016: 90). Në fund të shekullit XIX, Kolegji i Shën Adrianit e zgjeroi veprimtarinë e tij. Në vitin akademik 1903-1904 dëshmohet jo vetëm hapja e godinave të ristrukturuara, por edhe zgjerimi i ofertës arsimore të Institutit Ndërkombëtar Italo-Shqiptar. Komisioneri mbretëror Angelo Scalabrini ia arriti ta njësonte diplomën e Kolegjit me gjimnazin (1903), dhe

më interesantja, siguroi themelimin e një shkollë normale, për përgatitjen e mësuesve të shkollës fillore, që do ta ushtronin profesionin e tyre në Shqipëri, si dhe të një shkollë teknike të tipit “bujqësor” nga viti 1912 e në vazhdim (Fortino, 2013: 129). Pikërisht në ato kohë të vështira e të turbullta për Shqipërinë, Kolegji shërbeu edhe si qendër kulture e edukimi për rininë shqiptare. Që prej vitit 1898, deri më 1919, aty ndoqën mësimet mbi njëqind intelektualë shqiptarë, të cilët u bënë veprimtarë entuziastë në shërbim të atdheut e të arsimit kombëtar. Kolegji shërbeu dhe si shkollë e nivelit më të lartë për shkollat që ekzistonin në Shqipëri. Të diplomuarit në shkollat italiane në Shqipëri, por edhe të shkolluar të tjerë, fituan bursa italiane për të vazhduar studimet e tyre në Kolegjin e Shën Adrianit (Skëndi, 2000: 239).

Në vitin 1904, në atë Kolegj vazhdonin studimet: Kolë Kamsi, Pjetër Troshani, Luigj Kodheli, Zef Kurti, Lazër Prendushi, Ndoc Martin Camaj (Tare:2021: 85).

Kolegji u bë vatër e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare. Duke punuar aty, De Rada bashkëpunoi me rilindas të shquar shqiptarë, si: Zef Jubani, Thimi Mitko, Luigj Gurakuqi, i cili ishte nxënës i De Radës, pa harruar bashkëpunimin me Aleksandër Xhuvanin, studiuesin e çmuar të gjuhës shqipe, i cili shërbeu si mësues atje (Tare:2021:86).

Me nismën e De Radës, Skiroit dhe Aselmo Lorekios u mbajt i pari kongres në Corigliano Calabro në tetor 1895. Françesko Krispi u zgjodh president nderi. Duke pranuar nderin, ai i telegrafoi Kongresit që si “një shqiptar nga gjaku dhe zemra” ai ndihej i gëzuar për nismën e marrë, e cila, shpresonte ai, do të ishte e dobishme për historinë e qytetërimit të Shqipërisë dhe për

mbarësinë e letërsisë së saj. Kongresi i dytë u mbajt në Lungro të Kalabrisë në shkurt 1897. Programi i të dy kongreseve kërkonte: a. një alfabet të unifikuar; b. përpilimin e një fjalori, c. themelimin e një shoqërie kombëtare shqiptare d. nisjen e lidhjeve dhe të marrëdhënive në një shkallë të gjerë me mëmëdhenë. Si pasojë e Kongresit të parë, doli më 1896 revista “Ili i Arbëreshëve”, botuar nga kryepriifti Antonio Argondizza, një burrë me kulturë të gjerë dhe studiues i gjuhës shqipe (Skëndi, 2000 :202). Në Kongresin e Lungros qe vendosur të kërkohet nga qeveria italiane të krijohet një katedër e gjuhës dhe etetërisë shqipe në Institutin Oriental të Napolit. Më 1900 poeti Zef Skiroi u emërua aty dhe filloi leksionet e tij. Ishte mbajtur dhe një kongres tjetër në Napoli, ku u propozuaçelja e një katedre të re në Universitetin e Palermos. Këtu u morën edhe disa vendime të tjera: 1. dhënia e më shumë bursave shqiptarëve në mëmëdhe për studime në Kolegjin italo-shqiptar të Shën Adrianit në San Demetrio Corone; 2. fillimi i mësimit të gjuhës shqipe në shkollat publike të komuniteteve arbëreshe në Itali (Muceku & Haloçi: 2015 :140).

Shkollat italiane në Shqipëri

Shkollat në gjuhën italiane janë hapur të parat, nisur nga nevojat e tregëtisë. Nxënësit e mësuuan gjuhën italiane ndër shkolla private, si nismë e tyre, me mbështetjen e klerit katolik dhe të Konsullatës Austro-Hungareze në Shkodër, ku si lëndë mësimi u përdor gjuha shqipe, por edhe italishtja. Shkolla e parë, ku mësimi

zhvillohej në italisht u themelua nga Gegë Kodheli në vitin 1830. Gjashtë vjet më vonë, u hap një shkollë tjetër që përdorte italishten si gjuhë mësimi, e Gjergj Benusit. Ai ishte për shumë kohë oficer i Vezirit të Shkodrës. Disa familje shkodrane, pasi që nuk ishte më oficer, i kërkuan të hapte një shkollë, të cilën ai e hapi në 1836 (Kastrati, 1963: 63). Mësimet në këtë shkollë i jepte në italisht, pasi ai nuk dinte shqip. Shkollën e frekuentonin kryesisht fëmijët e tregtarëve, të cilët duke mësuar gjuhën italiane, do ta përdornin atë për t'i zhvilluar më lehtë marrëdhëniet tregtare, si dhe për arsimimin e tyre në Itali (Muceku, & Haloçi, 2015: 140). Meqenëse nxënësit e shkollës së Benusit u shtuan mjaft, u mendua se do të ishte mirë që të sillleshin mësues të përgatitur nga Italia për të themeluar një shkollë publike të rregullt. Kështu erdhën nga Venediku tre mësues italianë të quajtur Mark Rebeskini, Gjuriq dhe Luigj Kataliniq, të cilët së bashku me Benusin hapën një shkollë me katër klasë. Shkolla pati frekuentim të lartë. Tre mësuesit italianë qëndruan në Shkodër një farë kohe, e pas kthimit të tyre në Itali, Benusi e vazhdoi vetë aktivitetin e tij, duke qenë se ndërkohë e kishte mësuar mirë shqipen, pasi edhe ishte martuar në Shkodër (Kazazi, 2018:241-242). Pas Gjergj Benusit, kjo traditë u mbajt më tej nga i biri, i cili së bashku me të atin drejtoi shkollën, por ai botoi edhe një abetare në Bukuresht, në fund të së cilës është një fjalor i vogël italisht-shqip (Muceku, & Haloçi, 2015: 140).

Diku nga gjysma e '800, në Shkodër u lejua hapja edhe e shkollave të tilla si Shkolla Teknike Tregtare, Shkolla e Arizanatit dhe Profesioneve, Shkolla Fillore Italiane, në të cilat programi dhe mësimi bëhej në gjuhë të huaj, në këtë rast italisht, kjo edhe sepse këto shkolla

subvencionoheshin nga Italia (Osmani, 1963:44-45). Shkollë të vetën kishte edhe zotëria italian, Signor Shjor Markja (siç e thërrisnin shkodranët) (Kastrati, 1963: 64). Emri i tij i vërtetë ishte Marko Rebeskini. Ai erdhi nga Venediku dhe u martua në Shkodër. Punoi një periudhë kohe si farmacist, por pastaj meqenëse nuk i pëlqente kjo punë, hapi një shkollë për fëmijë ku u mësonte edhe italisht (Gurakuqi, 1928:92). Kemi të dhëna se një shkollë/kurs gjuhe italiane u hap në Shkodër edhe nga Giuseppe Vittoli, patriot italian, i cili erdhi në Shqipëri në vitet para bashkimit politik të Italisë. Vittoli, pas udhëtimesh të gjata u vendos në Shkodër, ku edhe hapi këtë shkollë kundrejt një pagese (private), e cila ndiqej nga fëmijët e familjevekatolike shkodrane të shtresës së lartë (Galletti, Simini, 2011:17).

Edhe urdhrat e jezuitëve dhe françeskanëve ishin aktivë dhe bënë përpjekje në hapjen e shkollave. Më 1854, Emzot Gjon Topiç OFM, në bashkëpunim me Propagandën Fide, ftoi Klaudio Stanislao-Nerin, i cili vlerësohej si ekspert i talentuar dhe besimtar, por edhe si person që njihte mirë gjuhën shqipe dhe zakonet e Shqipërisë, të bënte planin e ndërtesës shkollore dhe të fillonte punën për themelimin e një seminari kombëtar në Shkodër (Murzaku,2006:122), i cili u hap në vitin 1859. Seminari shërbeu për të gjitha vendet e juglindjes së Ballkanit dhe në vitin 1862 u emërtua Kolegji Papnor me varësi të drejtpërdrejtë nga Propaganda e Fesë (Papleka,2007 :18-19). Në atë kolegji mësoheshin gjuhët klasike: latinishtja dhe greqishtja e vjetër (Dushi, 2005:94), por edhe italishtja. Italisht mësohej dhe në Seminarin Françeskan, që u hap në vitin 1861 (Kurti,2003 :23). Veprimtaria e kësaj shkolle u zhvillua

më tej dhe brenda një kohe të shkurtër shtoi klasa të cilat shkonin nga dy në tre në secilën paralele dhe në vitin 1902 u shtua shkolla e mesme qytetare. Gjatë këtij viti shkolla numëronte Kolegjin Françeskan, Saurian-Jezuit, një shkollë fillore me 5 paralele, shkollë reale me 3 paralele dhe shkollë tregtare me tre paralele. Po atë vit u hap shkolla e mbrëmjes e cila frekuentohej nga çirakë dhe punëtorë të ndryshëm. Mësimi i gjuhës italiane në këtë shkollë u bë më i konsoliduar dhe u zhvillua më tej, nga mësimi i thjeshtë i të folurit të gjuhës deri te studimi i gramatikës italiane. Megjithatë duhet theksuar se të gjitha lëndët e tjera mësoheshin në gjuhën shqipe dhe kështu kjo shkollë ka qenë ndër të parat që ka prezantuar kurset e mësimi të gjuhës shqipe (Muceku & Haloçi, 2015: 140). Shkollë tjetër ku mësohej italishtja ishte Kolegji Saverian, i cili u hap më 17 tetor 1877, me themelues At Luigi Mazza. Në shkollë mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, por një nga lëndët kryesore ishte gjuha italiane, e cila ishte shumë e kërkuar nga njerëzit (Muceku & Haloçi, 2015: 141).

Krahas arsimimit të djemve, një vend të rëndësishëm në sistemin arsimor në Shkodër kishte shkollimi i vajzave. Shkolla e parë e vajzave, e hapur në këtë qytet, u themelua nga motrat Stigmatine në vitin 1879 dhe funksionoi si shkollë fillore, gjysëm e mesme dhe më vonë si shkollë e mesme. Në klasat e ulëta mësimi jepej në shqip, ndërsa në klasat e larta italisht dhe shqip (Muceku & Haloçi, 2015: 141).

Kur Italia doli në skenën e arsimit si rivale e Austrisë, kjo e fundit e kuptoi se vazhdimi i italishtes si gjuhë e mësimi në shkollat me karakter fetar ishte në dëm të saj, prandaj e kufizoi përdorimin e italishtes dhe futi

gjuhën shqipe në vend të saj, kurse në shkollat tregtare futi gjuhën gjermane (Skëndi, 2000:241-242). Me shtimin e depërtimit italian, Perandoria Austro-Hungareze, duke filluar nga vitet 1880, rriti vazhdimisht shpenzimet e saj për protektoratin e kultit në territorin shqiptar (Csaplár-Degovics: 23). Nga ana tjetër, Roma filloi të financonte një pjesë të klerikëve italianë dhe të nxiste nismat që gjithnjë e më shumë seminaristë të ardhshëm të zgjidhnin seminarët italiane për studimet e tyre.

Me bashkimin e Italisë, shkollat italiane në Shqipëri u bënë pjesë e projektit për shkollat italiane jashtë vendit, të cilat u krijuan fillimisht për italianët që jetonin jashtë dhe pastaj edhe për të përhapur ndikimin italian në vende të ndryshme. Duke qenë se nuk mundi të përfitonte të drejtën e Protektoratit të kultit mbi Shqipërinë, fillimisht Italia hapi vetëm shkolla laike; në vitin 1888- dy shkolla laike në Shkodër, një për djem dhe një për vajza, me italishten si gjuhë të mësimdhënies (Skëndi, 2000:128), si dhe shkollat në Prevezë, Vlorë e Durrës, të cilat në varësi të situatave të brendëshme dhe ndërkombëtare do të shtoheshin apo do të pakësoheshin, por gjithnjë do të kishte një prani të tyre në territoret shqiptare. Në vitin 1891, gjatë qeverisë së Rudinit, shkollat e mesme italiane të Prevezës, Vlorës dhe të Durrësit u mbyllën, ndërsa shkollat fillore në ato qytete vazhduan të funksionojnë (Skëndi, 2000: 239). Por në vitin 1899, një shkollë tregtare italiane u themelua në Shkodër, e ndjekur nga shkolla fillore e shkolla nate, si dhe nga kopshte fëmijësh e shkolla tregtare në qytete të tjera të Shqipërisë, si : Durrës, Vlorë, Janinë dhe në Gjirokastër (Skëndi, 2000 :239). Një rol të rëndësishëm luajti përpjekja për tërheqjen e studentëve shqiptarë në

Itali etj (Sota, 2021:83).Interesat italiane favorizoheshin edhe nga fakti se shkollat italiane ishin falas, ndryshe nga ato që i përkisnin protektoratit të kultit, edhe nëse në këtë të fundit ishte futur përdorimi i gjuhës shqipe (Csaplár-Degovics, 23-24).

Sistemi shkollor laik italian përfshinte gjithashtu shtypjen masive të librave, broshurave, gazetave dhe botimeve të tjera në italisht. Për të promovuar pretendimet e saj politike dhe territoriale, Mbretëria e Italisë, pas hapjes së shkollave dhe institucioneve fetare në Shqipëri dhe pas financimit dhe formimit të shoqatave shqiptare në territorin italian, lejoi botimin e disa revistave, duke përfshirë“Avanti”, “Lavoro di Genova”, “Nuova Antologia” e “Impressioni d’Albania”. Sipas shkrimeve të botuara në këto gazeta, në Itali jetonin rreth dyqind mijë shqiptarë, shumica e të cilëve emigruan nga shek. XV, kur Shqipëria u pushtua nga Perandoria Osmane (Hoti-Dani, 2014: 16-17).

Gjuha italiane ishte më e njohura në Shkodër. Nga njëra anë, programi arsimor, në përputhje me diplomacinë kulturore italiane të ndjekur në territorin shqiptar, iu përgjigj synimeve të qeverisë italiane, për t’i zhvendosur këto territore nën ndikimin e saj dhe për të krijuar një treg lokal të favorshëm për Italinë. Nga ana tjetër, vihet re edhe synimi i qartë për të realizuar një zgjim të ndërgjegjes kombëtare shqiptare (Lorenci: 83). Di San Giuliano që vizitoi Shqipërinë në vitin 1903(kur ishte deputet) theksoi gjithashtu rëndësinë e shkollave në gjuhën shqipe për formimin shkallë-shkallë të një ndërgjegje të vërtetë. Për këtë qëllim, aibëri thirrje për revokimin e ndalimit të mësimi të shqipes nga ana e Portës (Skëndi, 2000 : 239-240).

Jo vetëm italianë të shquar, por edhe organizata kulturore italiane kanë këshilluar përkrahjen e kulturës shqiptare. Në Kongresin XII të Shoqërisë “Dante Aligeri” në shtator të vitit 1901, u shpreh dëshira që qeveria e Romës të shqyrtonte mundësinë e rihapjes së shkollave në Durrës, Vlorë dhe Prevezë. Në të njëjtën kohë, Kongresi i besoi Këshillit të vet të Përgjithshëm të ndihmonte, për sa të ishte e mundshme, në përhapjen e kulturës italiane në Shqipëri dhe zhvillimin e kulturës shqiptare atje dhe në Itali (Skëndi, 2000 : 239-240). Ishte pikërisht kjo Shoqëri që ishte e angazhuar në përhapjen e gjuhës dhe kulturës italiane në botë (Caparelli, 1985: 11).

Në fillim Italia ndihmoi shkollat në gjuhën italiane por, duke filluar nga viti 1890, filloi të kontribuonte materialisht edhe shkollat në gjuhën shqipe. Duke iu referuar një raporti konsullor austro-hungarez, rezulton se në Shkodër, në vitin 1909, qeveria italiane ndihmoi në financimin e 6 shkollave, ndërsa në prag të Luftës së Parë Botërore numri i shkollave të financuara u rrit në 21 (Sota, 2021:83).

Italia mbështeti bashkëpunimin në mes arbëreshëve të Italisë dhe shqiptarët në anën tjetër të Adriatikut, çfarë do ta favorizonte politikën italiane për të forcuar ndikimin e saj në Adriatik. Një meritë të veçantë për inaugurimin e politikës aktive në drejtim të Adriatikut Lindor, veçanërisht ndaj Shqipërisë, pati pa dyshim kryeministri italian Francesco Crispi, me origjinë arbëreshe. Vizioni i tij politik i vështroonte interesat e qeverisë italiane në gadishullin e Ballkanit, veçanërisht në Shqipëri (Tare, 2011:251).

Shkollat italiane në Shqipëri vazhduan edhe pas shpalljes së Pavarësisë, me të njëjtat synime për të ruajtur

dhe shtuar ndikimin e shtetit italian. Pavarësisht këtyre synimeve politike, ato shkolla e patën një të mirë se ndikuan në përmirësimin e nivelit arsimor të shqiptarëve, duke ndikuar në zhvillimet politike dhe shoqërore në vend.

Bibliografi:

- Francesco Altimari, *Gli Arbëreshë d'Italia per la rinascita dell'Albania tra XVIII e XIX secolo: parallelismi con altre diaspore di area italo balcanica*, https://www.academia.edu/24927912/GLI_ARBERESHE_DITALIA_PERLA_RINASCITA_DELLALBANIA_PARALLELISMI_IN_AREA_BALCANICA
- Altimari, Francesco. *Napoli, vatër e rëndësishme e Rilindjes arbëreshe dhe shqiptare (shek. XVIII-XIX)*, p.4, https://www.academia.edu/24927897/Napoli_vat%C3%ABr_e_r%C3%ABnd%C3%ABSishme_e_Rilindjes_arb%C3%ABreshe_dhe_shqiptare_shek_XVIII_XIX
- Basciani, Alberto. *"I rapporti tra Italia e Albania tra le due guerre mondiali"*. Un profilo in Nuova Rivista Storica anno XCVII fasc. 2, 2013
- Caparelli, Filippo(1985). *La "Dante Alighieri" 1920 1970*, Roma.
- Csaplár-Degovics, Krisztián. *"La rivalità fra l'Italia e l'Impero austro-ungarico concernente l'Albania (1878-1912)"*, p. 2. http://real.mtak.hu/71233/1/Csapl%C3%A1rDegovics_Larivalta.pdf
- Dushi, Mark. (2005). *"Tirana dhe rrethinat e saj"*, Tiranë, botimet "Toena".

- Hoti-Dani, Esmeralda.(2014) (Dissertazione) *Le istituzioni educative in Albania dal 1978 al 1913, Il ruolo della manualistica scolastica nella formazione dell'identità nazionale albanese*,Università degli studi di Macerata.
- Draga, Nail.(2018). “*Roli i Austro-Hungarisë në shkollimin shqip në Mal të Zi (1916-1918)*”, revista “Gegnia” Nr,7, viti 2018.
- Fortino, Costante Italo. “ *L'attività dell'Istituto internazionale di san Demetrio Corone per l'Albania, in L' Albania indipendente e le relazioni italoalbanesi(1912-2012)* ”, A cura di Alberto Becherelli e Andrea Carteny , Atti del Convegno in occasione del Centenario dell'Indipendenza albanese, a cura dell'Università "La Sapienza", Roma 2013.
- Galletti, Mirella& Simini Gennaro. “*Esule e medico nell'Albania Ottomana*”, në Giacinto Simini, Un patriota leccese nell'Albania Ottomana, Argo, Lecce, 2011.
- Gurakuqi, Karl. “*Françeskanët në Shqypni*”, në “Dituria”, nr. 3, 1928.
- Kazazi, Lindita. “*Kahe perëndimore të arsimit në Shkodër dhe mësimi i italishtes si gjuhë e huaj nëpër shkollat e Shkodrës(deri në fillim të shekullit XX)*”, Buletini shkencor i Universitetit të Shkodrës, Seria e shkencave të edukimit Viti XLVIII (68), Shkodër 2018.
- Kuçi, Blerina.(2021). “*Shkollat katolike gjatë pushtimit italian (prill 1939-shtator 1943)* ”, Studime Historike Nr.1-2.
- Muceku, Albana, Haloçi, Andomaçi.(2015). “*Presence of Italian Language in the Albanian Education System during the, Years 1800-1944*”, Journal of Educational

and Social Research, Vol. 5 No.3 September 2015, MCSER Publishing, Rome-Italy.

- Murzaku, Ines A. *Catholicism, culture, conversion: the history of the Jesuits in Albania (1841-1946)*, Pontificio Istituto Orientale, Roma, 2006.
- Kastrati, Jup. Kontribut për historinë e arësimit në rrethin e Shkodrës deri në vitin 1912, në Arësimi popullor, nr. 2, 1963.
- Kurti, Donat.(2003). *Provinca Françeskane Shqiptare*, botimet françeskane Shkodër.
- Lorenci,Markenc, *L'emigrazione italiana nell'Albania pre-indipendente: il caso di due esuli italiani nella seconda metà del XIX secolo*, p.83,https://www.academia.edu/51643589/L_emigrazione_italiana_nell_Albania_pre_indipendente_il_caso_di_due_esuli_italiani_nella_seconda_met%C3%A0_del_XIX_secolo
- Murzaku, Ines A. "Ad maiorem Dei gloriam: The Jesuits in Albania," Occasional Papers on Religion in Eastern Europe: Vol. 37 : Iss. 6 , Article 4, 2017, p.8485;https://digitalcommons.georgefox.edu/ree/vol37/iss6_4
- Osmani, Shefik. Mësuesit dhe shkollat e para në Shkodër për gjuhën dhe lirinë kombëtare, në Arësimi popullor, nr. 3, 1963.
- Papeleka, Anisa.(2007). "Urdhëri i Jezuitëve, përhapja e shkencës dhe e dijes edhe te shqiptarët", gazeta "Shqip", viti II, Nr.119 (411), e premte 4 maj 2007
- Sawicka, Irena.(2015) "A Crossroad Between West, East and Orient- The Case of Albanian Culture", Colloquia Humanistica, 6.
- Skëndi, Stavro.(2000). "Zgjimi kombëtar shqiptar 1978-1912", Mendimi shqiptar, përkthyer nga Skënder Luarasin, Nestor Nepravishta, Phoenix and Shtëpia i Librit dhe e Komunikimit, Tiranë.

- Sota, Jani. *“Albania and the Education Policies of Italy from the beginning until the end of the 30s of the Twentieth Century in Archival Documents and in the Albanian Press in General”*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol 10 No 3, May 2021.
- Shllaku, Ludovik.(2002)*Shkollat klerikale, vështrim historik nga fillimet deri më 1924*, Shkodër, botimet “Camaj-Pipa.
- Tare, Denisa.(2021).*“Kolegjet arsimore arbëreshe”*, Revista Albanon, 2 (2).
- Tare, Denisa. *“Italian Politics and Albanian National Movement in the end of XIX-th and the begining of the XX-th”*, Mediterranean Journal of Social Sciences, Vol. 2, No. 3, September 2011.
- Vaccaro, Attilio.(2008). *”Il pontifi cio Collegio Corsini: presidio di civiltà e ortodossia per gli albanesi di Calabria”*, Hylli i Dritës Nr.3.
- Van Kessel, Tamara. (2011). *Cultural promotion and imperialism: the Dante Alighieri Society and the British Council contesting the Mediterranean in the 1930*, University of Amsterdam.